URDHËR
Nr. 154, datë 1.4.2022

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër.
2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër.
3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër, me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Urdhri nr. 145, datë 30.3.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla", shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca